



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-003

Prishtinë, më 25 shkurt 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 25 SHKURT 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga OSBE: Floriana Shala dhe

Nga NDI: Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 21 dhe 22 shkurt 2011,
2. Shqyrtimi i propozimit për formimin e komisioneve parlamentare – numri dhe struktura e tyre.

1. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 21 dhe 22 shkurt 2011

Procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 21 dhe 22 shkurt 2011, u miratuan me vërejtjet e nënkryetarit të Kuvendit, Sabri Hamiti, që janë korrigjuar.

2. Shqyrtimi i propozimit për formimin e komisioneve parlamentare – numri dhe struktura e tyre

Kryesia, pasi diskutoi për formimin e komisioneve parlamentare – numrin dhe strukturën e tyre, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, që do të mbahet më 28 shkurt 2011, të diskutojë për formimin e komisioneve parlamentare – numrin dhe strukturën e tyre dhe Kuvendit t'i propozojë për të vendosur lidhur me to.

Pika shtesë:

1. Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin mars të vitit 2011

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me vendimin e Qeverisë, vendosi të mbahet mbledhja e Kuvendit më 3 mars 2011, me këtë:

R e n d d i t e

1. Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin mars të vitit 2011

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.